



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2978/5 prot

Datë 04.11.2025

V E N D I M
Nr. 1591/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.11.2025, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit, “E hapur” me Nr. REF-64893-10-14-2025 me objekt “Ndërhyrje rehabilituese në rrugët auto-pylore”, me fond limit 15,475,526.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 04-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “ISEC” SHPK me NIPT L41309004L dhe adresë: Rruga Kodra e Diellit, Apartamenti 27, Shkalla 2, Kati 5.
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Adresa: Sheshi "Skënderbej", Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15-10-2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-64893-10-14-2025 me objekt “Ndërhyrje rehabilituese në rrugët auto-pyjore”, me fond limit 15,475,526.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 04-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

II.2. Në datën 22.10.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur ankesa me numer online te ankeses A/2025/5996 dhe protokolluar me tonën me nr. 2978/2025, datë 22.10.2025 e operatorit ekonomik “ISEC ” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në piken 2 të nenit 112, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 2655/12 prot., datë 28.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2978/1 prot., datë 29.10.2025, është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “ISEC ” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Gjithashtu e njëjta shkresë me të njëjtën përmbajtje me nr. 2655/13 prot., datë 28.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2978/2 prot., datë 30.10.2025 është depozituar nëpërmjet postës në Komisionin e Prokurimit Publik.

II.5. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues "ISEC" SHPK dhe e ka njoftuar atë, se ka vendosur mos shqyrtimin e ankesës dhe anulimin e saj duke argumentuar se:

"Referuar pretendimit të ankimuesit, KSHA gjykon, se dokumentet e tenderit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe proporcionale me natyrën dhe objektin e kontratës.

1. Në përputhje me VKM nr. 42, datë 16.01.2008, klasifikimi i subjekteve në nivele (A-G) lidhet me kapacitetin financiar dhe teknik të tyre për të kryer punime në vlera të caktuara. Për kontrata me vlerë modeste (si në këtë rast, me vlerë 15,475,526 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzetë e gjashtë) lekë pa TVSH), çdo subjekt që zotëron një licencë të vlefshme përkatëse (NP-1 ose NP-4), pavarësisht nivelit, është objektivisht i aftë të kryejë punimet në këtë vlerë.

2. Mos-specifikimi i nivelit të klasifikimit nuk sjell pasiguri apo diskriminim, por përkundrazi, rrit konkurrencën duke lejuar pjesëmarrjen e një game më të gjerë operatorësh të licencuar. Në këtë mënyrë, AK ka respektuar parimin e barazisë dhe konkurrencës së ndershme, të parashikuar në nenin 45 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

3. Kërkesa për NP-4 dhe NP-1 është teknikisht e justifikuar, pasi objekti i kontratës përfshin punime infrastrukturore rrugore që, përveç shtresave rrugore, përfshijnë edhe ndërhyrje në terren dhe punime gërmimi. Kërkesa kumulative e këtyre kategorive siguron që operatori ekonomik të ketë aftësi të plota teknike për realizimin e të gjitha komponentëve të punimeve, pa qenë kufizuese apo joproporcionale.

4. Rregullat e prokurimit publik kërkojnë që kriteret të jenë të lidhura ngushtë me objektin dhe vlerën e kontratës, jo domosdoshmërisht të detajuara në nivel teknik të klasifikimit, kur kjo nuk ndikon në aftësinë zbatuese të subjektit.

Në këtë rast, Autoriteti Kontraktor ka vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe konkurrencës së ndershme. Përcaktimi i kategorive të licencimit NP-1 dhe NP-4 pa specifikimin e nivelit të klasifikimit është i justifikuar teknikisht dhe ligjërish, duke garantuar pjesëmarrje më të gjerë dhe aftësi të mjaftueshme për realizimin e kontratës.

Nisur nga sa më sipër argumentuar, KSHA vlerëson se pretendimi i palës ankimuese në lidhje me kundërshtimet e paraqitura për përcaktimet e pikës 2.1 "Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale" të dokumentave standarte të tenderit, për procedurën e prokurimit "Ndërhyrje rehabilituese në rrugët auto-pyjore" me Nr. REF-64893-10-14-2025, të kryer nga Autoriteti Kontraktor/Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit nuk qëndron.

II. Në pikën e dytë të kontestimit të tij operatori ekonomik ka kërkuar që për lehtësi të procedurës dhe për të nxitur konkurrencën të modifikohet/hiqet kriteri përcaktuar sipas pikës 2.3.1a "punë të ngjashme(pyllezime)"

Autoriteti Kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, në dokumentat standarte, në pikën 2.3 Kapaciteti teknik ka kërkuar në mënyrë specifike sa më poshtë:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm punime (pyllëzime) në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 7,737,763 (shtate milion e shtateqind e tridhjet e shtate mije e shtateqind e gjashtëdhjetë e tre) leke pa tvsh dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Operatori ekonomik "ISEC" shpk në ankesën e paraqitur ka ngritur pretendimin se:

Teknika/eksperienca: kërkesa për "pyllezime" nuk është e lidhur me objektin (punime civile/rrugore)

AK kërkon "pune të ngjashme (pyllezime)", kur objekti dhe preventivat e tenderit janë tipike punimeve civile/rrugore (gërmime, shtresa baze, kanale anesore, tombino betoni, transport) - jo projekt pyllezimi.

Rregullorja kërkon që kriteret e kualifikimit të jenë të lidhura ngushtë me natyrën e kontratës; kur përcaktohet "punë e ngjashme", tipologjia duhet të reflektojë punime civile, jo pyllezim. Kërkesa aktuale deformon konkurrencën duke favorizuar subjekte të profilit të pyllëzimit dhe përjashton në mënyre të pajustificuar operatorë të fushës rrugore për të njëjtin objekt pune.

Sa i përket pragjeve të përvojës së ngjashme, Rregullorja parashikon: (a) një objekt i vetëm deri 50% të vlerës së kontratës dhe (b) vlerë e agreguar deri në 2-fishin e vlerës limit, brenda 5 viteve - plotësimi i njërit prej tyre mjafton për kualifikim.

Pra, edhe kur pragu është i saktë, lloji i punimeve duhet detyrimisht të jetë i njëjtë ose thelbësisht i ngjashëm me objektin (punime civile). Kërkesa për "pyllezim" shkel këtë lidhje.

Komisioni i shqyrtimit të ankesës shqyrtoi kërkesën e operatorit ekonomik mbi modifikimin e pikës 2.3.1 për kapacitetin teknik pune të ngjashme dhe konkludoi sa më poshtë vijon:

Gjatë rishikimit të dokumentacionit të procedurës së prokurimit publik me objekt "Ndërhyrje rehabilituese në rrugët auto-pyjore" me Nr. REF-64893-10-14-2025, KSHA ka konstatuar se Dokumenti Standard i Tenderit (DST) i miratuar dhe publikuar në sistemin e prokurimit elektronik nuk përputhet plotësisht me Relacionin Teknik të përgatitur nga grupi i punës teknik.

1. Konstatimi

Nga analiza e kryer rezulton se në DST, në seksionin kapaciteti teknik janë përfshirë elementë teknikë dhe përshkrime punimesh që devijojnë nga Relacioni Teknik dhe situata reale e objektit.

Këto mospërputhje prekin përshkrimin e zërit "pyllezim" në:

pikën 2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm punime (pyllezime) në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 7,737,763 (shtate milion e shtateqind e tridhjet e shtate mije e shtateqind e gjashtedhjetë e tre) leke pa tvsh dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; Kjo situatë krijon paqartësi mbi objektin real të kontratës dhe rrezik për zbatim të pasaktë të kontratës, në rast se procedura vijon mbi bazën e dokumenteve aktuale.

2. Arsyetimi

KSHA vlerëson se:

Teknika e Marrëdhënieve për dokumentimin e temës që pasqyron nevojën reale të ndërhyrjes dhe ka shërbime si bazë për hartimin e DST-së;

përdorimi i DST-së, siç është publikuar, nuk pasqyron saktësisht kriteret teknike të domosdoshme, duke krijuar mundësinë e përdorimit të drejtpërdrejtë që ndikojnë në përfitimet e ofertave nga operatorët ekonomikë;

për të siguruar, nuk garantohej parimi i transparencës dhe i trajtimit të operatorëve, pasi kërkohet nga ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

3. Vendimi / Propozimi

Në këtë rrethana, KSHA, për të shmangur zhvillimin e një procedure mbi dokumentacionin e pasaktës dhe për të siguruar ligjshmërinë e transparencës në prokurim, vendosjen e shërbimit të kësaj kërkesë dhe të propozimit të anulimit të procedurave aktuale në bazë të:

Neni 98, pika c) e Ligjit nr. 162/2020, i cili parashikon autorizimin e kontraktorit që mund të anulojë procedurat që duhet të vërtetohen me dokumentet e tenderit që përmbajnë gabime ose manipulime të rënda

Duke qenë se mospërputhjet ndërmjet Relacionit Teknik dhe DST-së janë të natyrës së nevojshme dhe të drejtat e autorizuar në shqyrtimin e procedurave, KSHA i propozon titullar Autorizimit Kontraktor anulimin e procedurave aktuale të prokurimit dhe rishikimit të dokumentacionit teknik për publikimin e tenderit pas rregullimeve të dokumentimit.

Referuar për të gjithë Komisionin e Shqyrtimit të ankesës:

VENDOSI:

Mosvazhdimin e vlerësimit të kërkesës së subjektit "ISEC" sh.p.k dhe propozon anullimin e procedurës aktuale të prokurimit publik "Procedurë e hapur" me objektin "Ndërhyrje rehabilituese në rrugët auto-pylore" me Nr. REF-64893-10-14-2025."

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "ISEC" SHPK, për modifikimin e dokumentave të tenderit lidhur me piken 2.1.1.: "...Licencimi: mungesë përcaktimi të nivelit të klasifikimit (A-G) dhe disproporcionalitet AK ka kërkuar NP-1 dhe NP-4 pa specifikuar nivelin e klasifikimit sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008, e cila përcakton si listën e kategorive (p.sh., NP-1 - Punime gërmimi në tokë; NP-4 - rrugë, autostrada, ura) Ashtu edhe klasifikimin e shoqërive sipas niveleve a-g në varësi të vlerave në lekë të punimeve për cdo kategori (A: 0-20 mln; B: 21-50 mln; G: mbi 800 mln). Mos-specifikimi i nivelit e bën kriterin jo të matshëm dhe jo të parashikueshëm, duke lejuar interpretim të lirë gjatë vlerësimit. Rregullat e Prokurimit Publik kërkojnë që kërkesat e veçanta të kualifikimit të jenë të përpjesëta dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe të specifikohen dokumentet konkrete që duhen paraqitur. Meqenëse vlera e kontratës është 15.475.526 lek pa TVSH, kërkesa për NP-4 (dhe, nëse ka arsye objektive, edhe NP-1) duhet të shoqërohet me nivelin përkatës të klasifikimit (p.sh. Niveli A për këtë

vlerë), në mënyrë që kriteri të jetë i qartë dhe proporcional me objektin. Gjithashtu, duke qenë se NP-4 përfshin punime rrugore me ndërhyrje që nënkuptojnë edhe gërmime dhe punime terreni, kërkesa në kumulim e NP-1 + NP-4 pa arsyetim teknik rrezikon të jetë e panevojshme dhe kufizuese. Sipas Rregullave, vendosja e kriterëve duhet të justifikohet dhe të jetë proporcionale me natyrën e kontratës.”. KPP konstaton se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ka dhënë sqarime të plota përsa është kërkuar në ankesë. Në nenin 75 të LPP-së parashikohet shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.”*. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor ka sqaruar këtë kriter që në vetëvete ka shkaktuar konfuzion e paqartësi tek operatorët që duan të marrin pjesë. Këto sqarime duhet të publikohen në SPE, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së, si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimin tjetër të ankimuesit, për modifikim e dokumentave të tenderit të paraqitur nga operatori ekonomik “ISEC” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, KPP vëren se:

III.2.1. Nëpërmjet shkresës nr. 2655/12 prot., datë 28.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2978/1 prot., datë 29.10.2025, është depozituar nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “ISEC ” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Gjithashtu e njëjta shkresë me të njëjtën përmbajtje me nr. 2655/13 prot., datë 28.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2978/2 prot., datë 30.10.2025 është depozituar nëpërmjet postës në Komisionin e Prokurimit Publik.

II.2.2. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “ISEC” SHPK dhe e ka njoftuar atë, se ka vendosur mos shqyrtimin e ankesës dhe anulimin e saj duke argumentuar se:

“Referuar pretendimit të ankimuesit, KSHA gjykon, se dokumentet e tenderit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe proporcionale me natyrën dhe objektin e kontratës.

VENDOSI:

Mosvazhdimin e vlerësimit të kërkesës së subjektit "ISEC" sh.p.k dhe propozon anulimin e procedurës aktuale të prokurimit publik "Procedurë e hapur" me objektin "Ndërhyrje rehabilituese në rrugët auto-pylore" me Nr. REF-64893-10-14-2025."

III.2.3. Neni 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Në nenin 3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

Në nenin 21 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”*

III.2.4. Në nenin 94, pika 1 “Paraqitja e ankesave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP-së, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik.”.

III.2.5. Në nenin 98 pika 1/ç dhe pika 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme;*
- b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme;*
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;*
- ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar;*

- d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.
2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna.
3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni.
4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit.
5. Autoriteti ose enti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afateve të ankimit sipas parashikimeve të nenit 110 të këtij ligji.”.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.2.7. Sa më sipër, konstatohet, se autoriteti kontraktor me shkresën nr. 2655/12 prot., datë 28.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2978/1 prot., datë 29.10.2025, informon se ka propozuar anulimin e procedurës së prokurimit, me arsyen se “*në seksionin kapaciteti teknik janë përfshirë elementë teknikë dhe përshkrime punimesh që devijojnë nga Relacioni Teknik dhe situata reale e objektit... Në këto rrethana, KSHA, për të shmangur zhvillimin e një procedure mbi dokumentacionin e pasaktës dhe për të siguruar ligjshmërinë e transparencës në prokurim, vendosjen e shërbimit të kësaj kërkesë dhe të propozimit të anulimit të procedurave aktuale në bazë të: Neni 98, pika c) e Ligjit nr. 162/2020, i cili parashikon autorizimin e kontraktorit që mund të anulojë procedurat që duhet të vërtetohen me dokumentet e tenderit që përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme.*”.. Në këtë kuadër, Komisioni konstaton, se ankesa e operatorit ekonomik nuk ka më objekt dhe ka rënë në dekadencë, pasi referuar parashikimeve të nenit 94, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, interesi i ligjshëm i ankuesit është i lidhur me veprimet apo mosveprimet e autoritetit kontraktor, ndërsa në rastin konkret veprimi i autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës do të çojë në rishikimin thelbësisht të kriterëve për kualifikim të cilat duhet të modifikohen sipas vendimit nr.563 datë 28.10.2025 të KSHA-së të autoritetit kontraktor pasi procedura do të rihidhet nga e para dhe kjo krijon konfuzion dhe pamundësi për Komisionin e Prokurimit Publik për shqyrtimin e kësaj ankese.

Ndërkohë vetë autoriteti kontraktor, si organi përgjegjës i zhvillimit të procedurës së prokurimit prokurimi, duhet të marrë masa për rishikimin thelbësor të kriterëve për

kualifikim të procedurës së prokurimit që do të ripublikojë, si dhe të modifikojë dokumentat e tenderit sipas vendimit nr.563 datë 28.10.2025 të KSHA-së si dhe të dërgojë në KPP dokumentat e reja të procedurës që do të rihedhë në zbatim të vendimit të sipërpërmendur.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ISEC” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-64893-10-14-2025 me objekt “Ndërhyrje rehabilituese në rrugët auto-pyjore”, me fond limit 15,475,526.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 04-11-2025 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
 2. Autoriteti kontraktor, të anullopë procedurën e prokurimit dhe brenda 5 ditëve, të paraqesë dokumentat standarte të procedurës së prokurimit që do të publikojë, në zbatim të vendimit të sipërpërmendur, të Komisionit të shqyrtimit të ankesës dhe të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “ISEC” SHPK “ISEC” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

